



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur nenit 13, të Rregullores Nr. 01-110/04-14194, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim për më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Raportit final të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës së Gjakovës lidh këtë:

K O N T R A T Ë

Për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës së Gjakovës

E hartuar me datën 06.04.2022 në Gjakovë, lidhur në mes të palëve kontaktuese, si më poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE:

- 1. Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës i cili e përfaqëson Komunën**, si dhënës i pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim për më pak se një (1) vit nga njëra anë dhe
- 2. Labërim Cërmjani – përfaqësues i OJQ-së “Fondacioni Bonevet Gjakovë”**, me numër të certifikatës së Regjistrimit të OJQ-së 5200307-5, përfitues - shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, e pronës së paluajtshme të Komunës së Gjakovës për vendosjen e një stacioni për riparimin e biçikletave, në hapësirat publike, përkatësisht përballë Bibliotekës së Qytetit, sipas kërkesës së prezantuar nga pala.

Neni 2
Kohëzgjatja e kontratës

Palët kontraktuese pajtohen që afati i shfrytëzimit të hapësirës së lartcekur të jetë deri me datën 31.10.2022, nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pas kalimit të afatit të paraparë në pikën 1, të nenit 2, të kësaj kontrate ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet pronarit, Komunës së Gjakovës.



Neni 3

1. Shfrytëzuesi obligohet, që në emër të kompensimit për shfrytëzimin e hapësirës komunale, përkatësisht të sipërfaqes prej 32 cm, të vendos logon e Komunës së Gjakovës në pajisjen për rregullimin e biçikletave të vendosur në hapësirën publike.
2. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë nga qiramarrësi.

Neni 4

Dhënia e pronës së paluajtshme dhe mënyra e shfrytëzimit

1. Komuna garanton se objekti i kësaj kontrate nuk ka të meta juridike.
2. Shfrytëzuesi nuk mund t'a ndryshojë ushtrimin e veprimtarisë së vet, por pronën që e ka marrë në shfrytëzim duhet ta shfrytëzojë vetëm për qëllimin e kërkuar ashtu siç e ka të paraparë më këtë kontratë.

Neni 5

Mbikëqyrja e kontratës

1. Prona e paluajtshme nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Komuna e Gjakovës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i bartet personit të tretë në shfrytëzim, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
2. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit mbikëqyr realizimin e kësaj kontrate.

Neni 6

Shkëputja e njëanshme e kontratës

1. Shkëputja e kontratës në mënyrë të njëanshme bëhet në rast të mospërmbushjes së obligimeve, nga shfrytëzuesi i pronës së paluajtshme, siç është përcaktuar në këtë kontratë.
2. Komuna e Gjakovës ka të drejtë që të shkëpusë kontratën para kalimit të afatit të caktuar, në rast kur i nevojitet hapësira e dhënë në shfrytëzim për investime apo për realizimin e ndonjë projekti të caktuar.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj kontrate dhe në rast të mosmarrëveshjes eventuale ndërmjet palëve kontraktuese, palët do të i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mes të palëve, atëherë kontesti do të zgjidhet në Gjykatë kompetente.

Neni 8
Kopja e kontratës

Kjo kontratë është përpiluar dhe nënshkruar në 3, (tri) kopje të njëjta identike prej të cilave nga 1, (një) kopje i takojnë secilës palë kontraktuese, kurse (1) një Drejtorisë përkatëse.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

P A L Ë T N Ë N S H K R U E S E


Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Labërim Cërmjani

Fondacioni Bonevet Gjakovë


